



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E I-rë E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 29 JANAR 2015

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:13**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakic.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - ngriti shqetësimin e migrimeve masive të kohëve të fundit, ku në mesin e migruesve ka edhe shumë nxënës të shkollave tona, prandaj për mbledhjen tjetër të kuvendit të komunës kërkoi që të përgatitet një informatë e cila pasqyron numrin e saktë të nxënësve të shkollave, si dhe numrin e qytetarëve që kanë migruar nga Komuna e Vushtrrisë, duke shtuar se shumë fshatra kanë filluar të boshatisen.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se është shqetësues numri i madh i qytetarëve jo vetëm të Komunës së Vushtrrisë, por nga e tërë Kosova që po migrojnë, duke shtuar se është një fenomen që është vështirë të ndalet. Në vazhdim njoftoi se në bazë të evidencave të Drejtorisë për Arsim në gjysmëvjetorin e dytë kanë braktisur mësimin 226 nxënës si rezultat i migrimit, dhe fenomeni i migrimit po ndodh për shkaqe nga më të ndryshmet duke filluar nga papunësia, gjendja e rëndë ekonomike dhe shkaqe të tjera, por në të njëjtën kohë po ndodhin migrime edhe nga të punësuarit në institucione komunale, arsimore dhe shëndetësore.

Xhevat Lahu, drejtor i gjimnazit - reagoi lidhur me raportin që ka paraqitur Komiteti Këshillëdhënës për Arsim, kur ishte fjala për shkollën e gjimnazit, duke shtuar se raporti në fjalë ka qenë zhgënjyes dhe ka etiketuar negativisht profesorët më meritorë dhe të përkushtuar për nxënësit dhe arsimin në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj tha se raporti në fjalë ka komprometuar të gjithë profesorët e gjimnazit, pasi që nuk është bërë vlerësim i bazuar në

fakte, si dhe ka profesor që është vlerësuar vetëm nga një nxënës, por ka edhe profesor që nuk janë vlerësuar fare.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se me shqetësim të madh dhe me keqardhje e ka pranuar raportin e paraqitur nga Komiteti Këshillëdhënës për Arsim, pasi që historikisht gjimnazi i Vushtrrisë ka përgatitur dhe është duke përgatitur kuadrot ndër më të mira në Republikën e Kosovës. Po ashtu tha se bazuar në rezultatet e viteve të fundit, gjimnazi i Vushtrrisë është ndër tri gjimnazet më të mira në kuadër të Republikës së Kosovës, prandaj këto suksese kanë ardhur si rezultat i punës dhe angazhimit të kolektivit të gjimnazit. Gjithashtu tha se është për keqardhje që të degradohen personalitete (profesorë) të cilët janë në fund të karrierës së tyre, të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në arsim. Në fund tha se Komiteti Këshillëdhënës për Arsim ka tejkalluar kompetencat e veta, pasi që nuk është në kompetencën e tij për të vlerësuar performancën e mësimdhënësve.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika nr. 6 "Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione", pasi që disa klube sportive nuk janë ranguar siç duhet, si dhe akoma nuk është i definuar statusi juridik i disa klubeve sportive.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit të Punës i Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2014.
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2014.
4. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe realizimi i investimeve kapitale.
5. Shqyrtimi i Draft-Planit i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2015/2019.
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.01Nr.97/14 të datës:24.04.2014 për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës-tokës bujqësore dhe kulloso.
7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë.
8. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.
10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e kriterëve për realizimin e projekteve në fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane në komunë.
11. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.
12. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet me vota unanime procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Raportit të Punës i Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2014.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2014.

4. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe realizimi i investimeve kapitale.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së tha se raporti në fjalë shoqërohet me mangësi, të cilat e vështirësojnë matjen e performancës së të hyrave të buxhetit komunal për këto arsye: në faqen nr. 1, në paragrafin 3 thuhet se shkurtimi për mallra dhe shërbime në vitin 2014 ishte 16 %, kurse në paragrafin 5 në të njëjtën faqe thuhet se shkurtimi në fjalë është 15 %, prandaj pyeti cila është e vërteta, dhe si ka mundësi që një dokument i komunës të krijojë huti dhe pasaktësi kur bëhet fjalë për krijimin dhe shpenzimin e parasë së taksapaguesve të Komunës së Vushtrisë; si mund të raportojë zyrtari kryesor financiar para kuvendit të komunës, dhe në faqen e parë, paragrafi 6 të thuhet se të hyrat e mbledhura nga komuna nuk janë definitive, pasi që të dhënat merren nga SIMFK-ja, kurse deri në momentin e raportimit akoma nuk janë alokuar mjetet financiare nga gjobat e gjykatës, sepse nëse ato gjoba janë të grumbulluara në një konto dhe që do t'i adresohen kontos komunale, atëherë ato në një tabelar shtesë duhet që të raportohen. Pastaj tha se tabelari zyrtar në parimin e të të gatshmeve të ishte një tabelar, por karshi tij do të duhej që të prezantohet edhe një tabelar në bazë të parimit akreal, i cili pasqyron gjendjen reale të të hyrave në momentin e dhënë kohor, andaj kjo metodologji e përfaqësuar nga komuna është mangësi e raportimit real të të hyrave dhe shpenzimeve nga komuna, kështu që kryetari do të duhej të ndërhynte tek hartuesit e raporteve për kuvendin për hir të raportimit më të kompletuar dhe më real në periudhën referuese <nuk është bërë e njëjta gjë edhe për të hyrat e gjobave në trafik, si dhe të hyrat e dhjetorit të vitit 2014; ka vërejtje në terminologjinë joprofessionale dhe jo të saktë që përdoret në raportin në fjalë, ku thuhet “dënimet e policisë”, duke mos përdorur të hyrat konkrete të referuara si të “hyra nga gjobat në trafik”, sepse dënimet mund të jenë të ndryshme; raporti në fjalë do të duhej të përmbante tabelarin e deshifruar në të cilin do të shkoqiteshin participimet në të hyrat komunale nga donacionet e brendshme, donacionet e jashtme, të hyrat e bartura nga viti i kaluar, të hyrat nga ushtrimi i veprimtarisë nga vitet e kaluara, të hyrat nga tatimi në pronë të inkasuara në këtë periudhë, por që janë të akruara (maturuara) në vitet e mëparme. Po ashtu tha se në një tabelë përmbledhëse profesionalisht me tregues tabelar të qartë, përqindje dhe deshifime të tjera, duke saktësuar se të hyrat e mbledhura në parimin e të gatshmeve sa janë të kësaj periudhe raportuese dhe sa janë të periudhave të akruara në të kaluarën, sepse vetëm kështu raporti në fjalë do të ishte i saktë, kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës, pasi që raporti është jashtë standardeve profesionale të raportimit të drejtë, duke shtuar se nuk është profesionale që para kuvendit të silllet raporti i njëjtë në formatin që i raportohet ministrisë, në bazë të parimit të KESH-it, sepse një raportim i tillë shoqërohet me mungesë të theksuar informatash bazike që nuk saktësojnë akruimin e të hyrave në komunë; komuna nuk ka përmbushur as për së afërmi objektivat për të siguruar premisat themelore të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, sepse niveli i të hyrave është në disproporcion me mundësitë reale të komunës; raporti nuk di të tregojë domosdoshmërinë e raportimit të qartë, të thjeshtë dhe të kuptuar edhe për nivelet joprofessionale; komuna nuk di si të kuptojë se raportimi në parimin e KESH-it duhet t'i bëhet vetëm ministrisë kompetente, sepse është obligim ligjor, ndërsa kuvendit të komunës raportimi duhet t'i bëhet edhe në parimin akreal, që është i vetmi mjet raportimi, i cili pasqyron gjendjen reale të performimit të komunës në periudhën referuese. Në fund tha se Grupi kuvendar i LDK-së kërkon që në të ardhmen kuvendit të komunës t'i raportohen të hyrat në bazën e maturimit akreal.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se raporti në fjalë është i qartë, i saktësuar dhe i kompletuar. Po ashtu tha se raporti në fjalë është hartuar në mënyrë profesionale ashtu siç

kërkohet për raportimet periodike dhe në fund të secilës tabelë ka sqarime. Në vazhdim tha se shkalla e realizimit të të hyrave arrin mbi 90 %, prandaj nuk ka vend për kundërshtime faktike.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit - lidhur me raportin në fjalë, tek “përmbledhja e të hyrave vetanake” kodi 180 pozicioni “parkingjet”, tha se shfrytëzimi i hapësirave publike (parkingjet) bëhet në çdo kënd të qytetit, por nuk inkasohen të hyra, pasi që edhe në tabelë shihet se realizimi është vetëm 12 %, duke shtuar se disa rrugë të qytetit janë të stërngarkuara me automjete të parkuara, por nuk inkasohen të hyra, prandaj drejtorja kompetente duhet të punësojë ndonjë punëtor apo të japë parkingjet me koncesion, sepse në të gjitha qytetet tjera praktikohet realizimi i të hyrave nga parkingjet. Në vazhdim paraqiti një shqetësim të qytetarëve lidhur me shëtitoren nga tregu i qytetit deri tek ura e lumit “Silnicë”, pasi që është shkatërruar nga qytetarët e pandërgjegjshëm mbi 50 % e ndriçimit publik, telat në shtylla elektrike janë të zhveshur dhe paraqesin rrezik potencial për fëmijë, ulëset janë pjesërisht të shkatërruara, ndërsa shportat e mbeturinave janë tërësisht të shkatërruara. Po ashtu shëtitorja nga ura e lumit “Silnicë” deri tek lagjja “Podranqa” e ndërtuar gjatë stinës së verës në vitin 2014 ka filluar në tri vende të shembet, dhe nëpër këtë shëtitore voziten traktorë me mbeturina dhe i hedhin në lum, ndërsa pengesat për kalimin e mjeteve transportuese në shëtitore janë shkatërruar. Në fund lidhur me kodin 470 tek “Drejtorja e Bujqësisë” për pozicionin “qiraja e tokës bujqësore” kërkoi një raport shtesë nga Drejtorja e Bujqësisë se sa hektarë tokë janë dhënë me qira, pasi që kuvendi i komunës ka dhënë me dhjetëra hektarë tokë me qira, kurse inkasimi i të hyrave nga qiraja e tokave bujqësore prej 8 % është shumë i ulët.

Zoran Rakic, anëtar i kuvendit - lidhur me shpenzimet e vitit 2014, kodi 195 pozicioni “Zyra lokale e komuniteteve”, tha se nga buxheti prej 42.194 €, kanë mbetur të pashpenzuara 2.490 €, edhe pse zyra lokale që tre muaj në fshatin Prelluzhë nuk ka rrymë, sikurse Qendra e kulturës në Prelluzhë që nuk ka rrymë prej një viti e gjysmë, duke shtuar se kanë mbetur disa punë të pakryera, ndërsa buxheti ka mbetur i pashfrytëzuar, prandaj pyeti se a është fajtorë Zyra lokale për komunitete që nuk i ka shfrytëzuar këto mjete apo Drejtorja për Buxhet dhe Financa, e cila nuk i ka respektuar procedurat. Në vazhdim shtoi se edhe në raportin vjetor të Komitetit për Komunitete ka paraqitur vërejtje për punën e Zyrës lokale për komunitete. Në fund njoftoi se për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike nga fshati Prelluzhë kanë migruar katër nxënës serb dhe katër nxënës rom, prandaj kërkoi që të ndërmerren masa për ndalimin e emigrimit të qytetarëve.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime shtesë për pyetjet dhe vërejtjet e anëtarëve të kuvendit lidhur me raportin në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar raportit në fjalë, tha se për kryetarin e komunës dhe qeverinë komunale është primare realizimi i investimeve kapitale, dhe me theks të veçantë realizimi i granteve qeveritare, kurse të hyrat vetanake edhe mund të barten prej vitit në vit. Në vazhdim njoftoi se qeveria komunale është duke përgatitur Draft-rregulloren për shfrytëzimin e të hyrave nga parkingjet, mirëpo paraprakisht duhet të evidentohen me sinjalizime horizontale të gjitha parkingjet, duke shtuar se qeveria komunale ka planifikuar mjete financiare që në këtë vit të ndërtohen parkingje të reja, pasi që të aprovet në kuvendin e komunës lista e propozuar për parkingje. Në fund i sqaroi anëtarit të kuvendit Z. Rakic se në muajin janar iu janë paguar borxhet e rrymës dhe nuk kanë tepruar mjete tjera.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se raporti në fjalë është tremujor, sepse raporti vjetor duhet të ketë diçka tjetër që e karakterizon këtë vit lidhur me të hyrat dhe shpenzimet. Po ashtu kërkoi që raportet të përgatiten në atë formë që të jenë të kapshëm dhe të kuptueshme për të gjithë anëtarët e kuvendit. Pastaj tha se në faqen nr. 5 të raportit thuhet “shfrytëzimi i pronës shoqërore”, por duhet të sqarohet se komuna nuk është titullare e pronës shoqërore, mirëpo është pronare e pronës komunale. Në vazhdim lidhur me dhënien e

pronave me qira, kërkoi që të inkasohen të hyrat nga dhënia e këtyre pronave me qira. Në fund tha se shpreson që do të ketë raport të veçantë lidhur me tatimin në të hyrat vetanake sipas viteve.

5. Shqyrtimi i Draft-Planit i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2015/2019.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - tha se draft-plani në fjalë duhet të përkrahet si dëshmi se institucionet tona janë të përkushtuara për avancimin e pozitës së komuniteteve joshumicë që jetojnë në Komunën e Vushtrrisë. Në vazhdim tha se draft-plani në fjalë nuk paraqet kosto të qartë financiare vjetore, ndërsa disa shpenzime të paraqitura nuk janë siç duhet të saktësuara, prandaj kërkoi që të dihet kostoja e saktë e shpenzimeve për implementimin e këtij plani. Po ashtu tha se para se të hartohet ky plan do të duhej të bazohej në një politikë të caktuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, legjislacionit apo edhe të ndonjë strategjie lokale. Tutje tha se Komuna e Vushtrrisë duhet të angazhohet për institucione demokratike, pa dallime etnike apo fetare, prandaj kundërshtoi bursat e veçanta që janë paraparë me këtë plan për pjesëtarët e komunitetit rom dhe ashkali, pasi që bursat për studim duhet të jepen sipas kriterëve dhe programeve arsimore dhe në këtë rast duhet të ketë vetëm lehtësira siç është nota mesatare më e ulët për komunitetet joshumicë. Gjithashtu në planet e punës së institucioneve arsimore dhe shëndetësore duhet të ketë program të veçantë të trajtimit në mënyrë permanente të këtyre kategorive, pa pasur nevojë për ndarje të veçantë të mjeteve financiare, kurse sa i përket programeve kulturo-artistike mjafton që të shfrytëzohen hapësirat e komunës, si dhe të krijohen kushte dhe mundësi për marrjen e granteve për këto aktivitete. Në fund kërkoi që të hiqet nga plani në fjalë çështja e 5 %-shit e marrjes në punë nga komunitetet joshumicë në rastin e fitimit të tenderëve në punët e komunës, pasi që është e vështirë të realizohet kjo çështje bazuar në rregullat e prokurimit dhe të tregut.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Plani i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2015-2019.

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.01Nr.97/14 të datës:24.04.2014 për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës - tokës bujqësore dhe kullosa.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë propozoi këto ndryshime dhe plotësime:

Shtojca 1 e Vendimit, e cila përmban parcelat të cilat jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari kryesisht për kultura "lavërtare" çmimi fillestar të jetë pesëdhjetë (50) euro për një (1) ha në vit. Shtojca 2 e vendimit e cila përmban parcelat, të cilat jepen në shfrytëzim afatgjatë me veprimtari kryesisht për kultura shumëvjeçare "pemishte" çmimi fillestar të jetë pesëdhjetë (50) euro për një (1) ha në vit. Pastaj propozoi një nen të ri me këtë përmbajtje: "për parcelat që jepen në shfrytëzim (me kompensim) afatshkurtër me sipërfaqe deri në dy (2) ha kanë të drejtë të aplikojnë vetëm personat fizik, ndërsa për parcelat që jepen në shfrytëzim (me kompensim) afatgjatë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm personat juridik".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 29 vota "për", 6 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet Vendimi për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës – tokës bujqësore dhe kullosave 01 NR.97/14 DT.24.04.2014.

Neni 1 i vendimit të lartcekur ndryshohet dhe plotësohet me sa vijon:

Shtojca 1 e vendimit e cila përmban parcelat, të cilat jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari kryesisht për kultura “lavërtare” çmimi fillestar të jetë pesëdhjetë (50) euro për një (1) ha në vit, në afat prej tre (3) viteve me mundësi vazhdimi edhe për tre (3) vite tjera.

Shtojca 2 e vendimit e cila përmban parcelat, të cilat jepen në shfrytëzim afatgjatë me veprimtari kryesisht për kultura shumëvjeçare “pemishte” çmimi fillestar të jetë pesëdhjetë (50) euro për një (1) ha në vit, në afat prej njëzetë (20) viteve.

Për parcelat që jepen në shfrytëzim (me kompensim) afatshkurtër me sipërfaqe deri në dy (2) ha kanë të drejtë të aplikojnë vetëm personat fizik, ndërsa për parcelat që jepen në shfrytëzim (me kompensim) afatgjatë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm personat juridik.

7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë.

Diskutimi publik fillon nga data 30 janar 2015 dhe zgjatë deri më 16 shkurt 2015.

8. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të PDK-së propozoi të formohet një komision nga kuvendi i komunës, i cili do t'i bashkëngjitet për punë të përbashkëta komisionit të formuar nga Drejtoria për Shërbime Publike, pasi që draft-rregullorja në fjalë nuk i ka të specifikuar disa çështje, siç është transporti i nxënësve nga viset rurale ku nuk ka numër të mjaftueshëm të nxënësve dhe nuk ka qasje të transportit publik.

Xhevahire Selmani, anëtare e kuvendit - për anëtar të komisionit nga PDK-ja propozoi Safet Osmanin.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit - për anëtar të komisionit nga LDK-ja propozoi Syzana Sylën.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit - për anëtar të komisionit nga LVV-ja propozoi Mehmet Selacin.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Draft-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

Safet Osmani (PDK);

Syzana Sylja (LDK);

Mehmet Selaci (LVV).

9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjeba Komunale.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se për çështjen e taksës në firmë është diskutuar në disa mbledhje të kuvendit, ku ka pasur pajtueshmëri që të hiqet taksa në firmë, por pasi që gjatë vitit 2014 nuk ka mundur që të hiqet taksa në firmë, shtoi se aplikimi i kësaj takse vjen në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi heqjen e taksës në firmë, pasi që në vitin 2011 qeveria ka marrë vendim për heqjen e “taksës mbi veprimtarinë”, dhe në atë kohë kanë shprehur kundërshtimin e tyre lidhur me këtë vendim vetëm tri komuna, por edhe përkundër vendimit të qeverisë Komuna e Vushtrrisë dhe disa komuna tjera kanë vazhduar aplikimin e taksës në firmë, por duke ia ndërruar emërtimin si “taksë mbi firmë”, prandaj propozoi që të hiqet taksa në firmë nga 1 janari 2015, e cila është ngarkesë dhe barrierë për zhvillimin e ekonomisë, por kjo nuk do të nënkuptonte falje të borxheve të mëparshme.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit - tha se Grupi kuvendar i LDK-së ka kërkuar edhe më herët që bizneset të lirohen nga taksa në firmë, pasi që taksa në firmë aplikohet vetëm në vendet socialiste, duke shtuar se edhe USAID-i ka rekomanduar heqjen e kësaj takse. Pastaj tha se disa komuna në Republikën e Kosovës e kanë hequr taksën në firmë, dhe me heqjen e kësaj takse, bizneset nuk amnistohen nga borxhet e pashlyera të taksës në firmë. Po ashtu tha se kjo taksë mund të konsiderohet një lloj haraçi, sepse ato janë të pajisura me leje të punës dhe të njëjtat paguajnë tatimet në pronë, tatimet dhe kontributet në Administratën Tatimore të Kosovës, prandaj komuna duhet t’ua lehtësojë funksionimin bizneseve, e jo t’ua vështirësojë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se qëndrimi i tij ka qenë dhe është që të mos lirohen të gjitha bizneset nga taksa në firmë, duke shtuar se e përkrah heqjen e taksës në firmë për të gjitha veprimtaritë prodhuese, por jo të lirohen bankat, lojërat e fatit dhe të ngjashme me to. Në vazhdim tha se Komuna e Vushtrrisë më herët ka liruar nga taksa në firmë (përmes rregullores) numër të konsiderueshëm të bizneseve. Në fund tha se në rast se hiqet në tërësi taksa në firmë, zyrtarëve të këtij sektori mund t’iu shuhet vendi i punës, si dhe planifikimi i mjeteve është bërë për këtë vit, prandaj nëse hiqet taksa në firmë, planifikimi zvogëlohet.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - propozoi që të hidhet në votim draft-rregullorja në fjalë ashtu siç e ka propozuar Drejtoria për Buxhet dhe Financa, duke ia bashkëngjitur edhe propozimet e paraqitura nga anëtarja e kuvendit M. Ismajli dhe të shtohen si të liruara nga pagesa edhe këto kategori: shurdhmemecët dhe të verbërit, si dhe të inkorporohet propozimi i kryetarit të komunës që të lirohen nga taksa në firmë të gjitha veprimtaritë prodhuese.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - tha se kuvendi i komunës ka formuar komision për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjeba Komunale. Pastaj tha se taksa në firmë ka bazë ligjore në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë ka liruar nga taksa në firmë mbi 50 % të bizneseve afariste, prandaj është e domosdoshme që disa biznese të paguajnë taksën në firmë. Në fund propozoi që të lirohen nga pagesa e certifikatave të lindjes edhe shurdhmemecët dhe të verbërit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjeba Komunale, duke inkorporuar propozimin shtesë të kryetarit të komunës dhe të drejtorit për Drejtori për Buxhet Financa.

10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e kriterëve për realizimin e projekteve në fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane në komunë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim caktohen kriteret për përfitim të projekteve nga buxheti i komunës për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Vushtrrisë.

Për ofrimin e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale duke përfshirë: rregullimin e rrugëve lokale, trajtimin e ujërave të zeza, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e mbeturinave, përparësi kanë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, të cilat kanë përmbushur obligimet për tatim në pronë në shkallë më të lartë.

11. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.

Syzana Syla, anëtare e kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, kërkoi informacione shtesë se sa mallra janë asgjësuar me afate të skaduara me kërkesën e pronarëve të lokaleve ushqimore (të inspektuara nga inspektorët e Drejtorisë për Inspektime) tek lokalet individuale ushqimore në vlerë prej 50.157 €, si dhe të ceket se cila është shuma me kërkesën e pronarëve, si dhe shuma e cila është si rezultat i kontrollit në terren nëpër lokale. Po ashtu kërkoi informatë nga Drejtoria për Inspektime se sa kontrole janë bërë gjatë vitit 2014 tek objektet hoteliere dhe për përgatitjen e ushqimit sa i përket pajisjes me librezë sanitare, duke e cekur numrin e librezave sanitare, si dhe numrin e fletëparaqitjeve që janë proceduar në gjykatë dhe sa është shuma e gjobave, sa lokale janë inspektuar për shkeljen e orarit të punës pas orës 24:00, pasi që ka pasur shumë ankesa nga qytetarët për mosrespektimin e orarit.

12. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11:33.

Albanez Tahiraj

Procesmbajtës

